



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURES
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 869 Prot.

Tiranë, më 06.06 2018

VENDIM Nr. 132, datë 27.06.2018

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 6, datë 27.06.2018, pasi shqyrtoi kërkesën nga shoqëria "A.K.e.R" sh.p.k. për dorëzimin e gjetjeve arkeologjike të dala nga:

-Gërmimi i shpëtimit i kryer sipas vendimit të KKA Nr. 249 datë 13.12.2017, në kuadër të projektit "Ndërtesë banimi 4-5 kate dhe 1 kat nën tokë", Lagja 1, rruga "Nako Spiro" dhe rruga "De Rada", Durrës-subjekti "FAKLE" sh.p.k.

-Gërmimi i shpëtimit i kryer sipas vendimit të KKA Nr. 57, datë 20.03.2018 në kuadër të projektit "Godinë banimi 5 kate dhe 1 kat nëntokë" në lagjen Nr.1, rruga "Mbretëresha Teuta", në zonë arkeologjike "B"- subjekti "REI" sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Gjetjet e dala nga gërmimet e sipërpërmendura të depozitohen pranë fondeve të DRKK Durrës.
2. Dorëzimi i tyre të kryhet konform kritereve të përcaktuara në Rregulloren "Kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut; Kriteret e Gërmimit, Dokumentimit dhe Arkivimit të të Dhënave dhe Materialeve Arkeologjike; Kriteret dhe Procedurat Administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe shoqëri private" (e ndryshuar), miratuar me vendim KKA Nr. 2 datë 30.01.2009.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FEKENTI
MINISTËR



SEKRETARI I KKA
RUDINA ZOTO

